

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a., Tirana

Informacion sipas Rregullores “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga Bankat dhe degët e bankave të huaja”

(Sipas Kërkesave të Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008, ndryshuar me vendimin nr. 25, datë 01.04.2015, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

Për periudhën e mbyllur më 30 Qershor 2024

PËRMBAJTJA:

Aneksi 1

Tabela 1: Informacion mbi aktivitetin kryesor, organizimin, drejtimin dhe kontrollin e bankave

1. Informacion i përgjithshëm mbi bankën.
2. Informacion i përgjithshëm mbi degët e bankave të huaja
3. Informacion mbi strukturën e organizimit, të administrimit dhe të funksionimit të bankës duke përfshirë njësitë e saj funksionale dhe administrative, funksionet e tyre dhe marrëdhëniet raportuese dhe kontrolluese.
4. Informacion mbi aktivitetet e bankave.
5. Informacion mbi filialet e bankave dhe sipërmarrjet në të cilat bankat janë aksionere kryesore.
6. Informacion mbi borxhin e varur të Bankës.
7. Informacion mbi sipërmarrjet mëmë dhe sipërmarrjet aksionere kryesore në banka.
8. Informacion i degës së bankës së huaj lidhur me bankën-mëmë.

Aneksi 2

Tabela 2: Bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe në veçanti tregues të rentabilitetit

Tabela 3: Struktura e kapitalit rregullator

Tabela 4: Mjaftueshmëria e Kapitalit

Tabela 5: Informacion i përgjithshëm cilësor për ekspozimin ndaj rreziqeve

Tabela 6: Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm

Tabela 7: Rreziku i kredisë: Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standard

Tabela 8: Teknikat e zbutjes së rrezikut

Tabela 9: Rreziku i kredisë së kundërpartisë

Tabela 10: Titullzimi

Tabela 11: Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm

Tabela 12: Rreziku operacional

Tabela 13: Ekspozimet në instrumenta të kapitalit: informacion mbi pozicionet e përfshira në librin e bankës

Tabela 14: Rreziku i normës së interesit në librin e bankës

Tabela 15: Rreziku i likuiditetit

Tabela 16: Depozita ekuivalente e kapitalit të degës së bankës së huaj

Tabela 17: Matja dhe kontrolli i kufijve të rrezikut të degës së bankës së huaj

Tabela 18: Politikat e shpërblimit

Tabela 19: Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë

Tabela 20: Politikat kontabël

Tiranë, më 30/06/2024

Aneksi 1

Tabela 1: Informacion mbi aktivitetin kryesor, organizimin, drejtimin dhe kontrollin e bankave

1. Informacion i përgjithshëm mbi bankën

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a. është një bankë tregtare me numër unik identifikimi (NUIS) J62001011Q, themeluar në datën 01/01/1993 e cila ofron një gamë të gjerë me shërbime të plota.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI BANKËN

Emri Subjektit	Banka Kombetare Tregtare
Forma juridike	Shoqeri Aksionere
Adresa	Tirane_Rruga e Vilave, Lunder 1
Numri – NIPT	J62001011Q
Data e themelimit	01/01/1993
Shuma kapitalit te regjistruar	350,000,000.35 USD
Shuma kapitalit te paguar	350,000,000.35 USD
Numri i aksioneve të emetuara	28,340,081
Vlera nominale e aksionit	12.35 USD
Rritja e kapitalit gjate tremujorit	N/A
Numri i aksioneve te rritura gjate tremujorit	N/A
Vlera nominale e kapitalit te rritur gjate tremujorit	N/A

PASQYRA E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT AKSIONAR MË 30 QERSHOR 2024

(000/ lekë)	Kapitali Aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva rivlerësimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	33,727,923	6,840,633	(5,545,923)	14,220,208	49,242,841
Krijimi i rezervës ligjore	-	393,079	-	(393,079)	-
Rritja Kapitalit Aksionar	4,826,000	-	-	(4,826,000)	-
Dividend për t'u paguar	-	-	-	(4,826,000)	(4,826,000)
Fitimi Neto per periudhen	-	-	-	4,207,184	4,207,184
Fitimi i pashpërndarë nga operationet e huaja, i rregulluar me kursin e fundit të vitit	-	-	-	(1)	(1)
Lëvizje në rezervën e rivlerësimit	-	-	(213,000)	-	(213,000)
Gjendja më 30 Qershor 2024	38,553,923	7,233,712	(5,758,923)	8,382,312	48,411,024

INFORMACION MBI AKSIONERËT QË KANË PJESËMARRJE INFLUENCUESE


Emri tregtar	Çalk Holding
Forma juridike	Shoqeri Aksionere
Adresa e regjistruar	Buyukdere Cad. No.163, 34394 – Zincirlikuyu, Istanbul-Turkey
Përqindjen e aksioneve me të drejta votimi	100%

BKT është krijuar në formën aktuale ligjore më 30 dhjetor 1992, megjithëse dega e saj e parë është hapur në 30 nëntor 1925. BKT është subjekt i Ligjit nr. 8269 “Mbi Bankën e Shqipërisë” me dhjetor 1997 dhe i Ligjit nr. 9662 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të datës 18 dhjetor 2006.

2. Informacion i përgjithshëm mbi degët e bankave të huaja

N/A

3. Informacion mbi strukturën e organizimit, të administrimit dhe të funksionimit të bankës, duke përfshirë njësitë e saj funksionale dhe administrative, funksionet e tyre dhe marrëdhëniet raportuese dhe kontrolluese



Drejtoria e Përgjithshme e BKT ndodhet në Tiranë. Aktualisht në Shqipëri, Banka zotëron një rrjet prej 60 degësh dhe 3 agjencish doganore. Njëzet e gjashtë prej degëve ndodhen në Tiranë dhe të tjerat në Durrës, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Fier, Pogradec, Korçë, Bilisht, Gjirokastrë, Delvinë, Sarandë, Orikum, Berat, Kuçovë, Lushnjë, Librazhd, Peqin, Rrogozhinë, Shkozë, Kavajë, Vorë, Kamëz, Fushë Krujë, Laç, Lezhë, Rrëshen, Kukës, Peshkopi, Bushat, Koplik, Gramsh dhe Skrapar, të ndjekura nga agjencitë doganore në Portin e Durrësit, Çorovodë dhe Aeroportin e Rinasit.

Banka kishte 1,048 punonjës (31 dhjetor 2023: 1050) në datën 30 Qershor 2024, nga të cilët 529 (31 dhjetor 2023: 523) i përkasin Drejtorisë së Përgjithshme.

4. Informacion mbi aktivitetet e bankës

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a., në përputhje me liçencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë si dhe me kriteret e përcaktuara në Ligjin Bankar, mund të ushtrojë aktivitetet e mëposhtëme financiare:

- (1) Të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore dhe hipotekare;
- (2) Qiraja Financiare;
- (3) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
- (4) Ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve;
- (5) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetëorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
 - i. Instrumente të tregut të parasë (çeqe, dëftesa, çertifikata depozitash etj.);
 - ii. Këmbim valutor;
 - iii. Produkte derivative (instrumente derivative), duke përfshirë, midis të tjerave, kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me opsione (options);
 - iv. Instrumente të këmbimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla si marrëveshje *swap* dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen (forward agreements);
 - v. Letra me vlerë të transferueshme;
 - vi. Instrumenta të tjerë të negociueshëm dhe aktive financiare, duke përfshirë veprimet me arin;
 - vii. Pjesëmarrjen në emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, duke përfshirë nënshkrimin dhe vendosjen si agjent (si publik, ashtu edhe privat) dhe kryerjen e shërbimeve lidhur me këto emetime;
- (6) Ofrimin e shërbimit të klasave të sigurimit;
- (7) Faktoring-un dhe financimin e transaksioneve tregtare;
- (8) Ndërmjetësimin për transaksionet monetare të mëposhtme:
 - i. Administrimin e aktiveve të tilla si administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve, marrja në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit;
 - ii. Shërbimin për kompensimin dhe shlyerjen e pagesave të aktiveve financiare, duke përfshirë letrat me vlerë, produktet derivative dhe instrumente të tjera të negociueshme;
 - iii. Sigurimin dhe transferimin e informacionit financiar si dhe përpunimin e të dhënave financiare e të programeve që kanë lidhje me të nga furnizuesit e shërbimeve të tjera financiare;

(9) Shërbimet këshilluese, ndërmjetësuese dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara nga pika (1) deri në (9) këtu më sipër, duke përfshirë referencën e kredisë dhe të analizës, kërkimin dhe këshillimin në lidhje me investimet dhe portofolin si dhe këshillimin mbi blerjet e mbi strategjinë dhe ristrukturimin e shoqërive; kujdestar i letrave me vlerë të qeverisë.

(10) Emetimin dhe administrimin e instrumentave të pagesës (të tilla si kartat e kreditit dhe të debitit, çeqet e udhëtarit dhe çeqet bankare, kartat e pagesës dhe pagesat me celular) etj., përfshirë emetimin e parasë elektronike.

5. Informacion mbi filialet e bankave dhe sipërmarrjet në të cilat bankat janë aksionere kryesore

Filialet

Filialet janë njësi (degë) të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka ka fuqi mbi një njësi ekonomike, është e ekspozuar, ose ka të drejta mbi përfitimet e ndryshueshme nga përfshirja e saj tek njësia, dhe ka aftësinë për të përdorur fuqinë e saj për të ndikuar në përfitimet e njësisë.

Investime në filiale

Investime në pjesëmarrje dhe filiale në vlerën 3,600,656 mijë Lek (31 dhjetor 2023: 3,583,818 mijë Lek) përfaqëson kundravlerën e investimit në shumën prej 2,300,000 Euro (230,713 mijë Lek) dhe vlerën e investimit në shumën prej 140,001 Lek, në kapitalin aksionar të "BKT Pay", kundravlerën e investimit në shumën prej 1,199,600 Euro (120,332 mijë Lek) në kapitalin aksionar të kompanisë Albania Leasing Sh.a. me normë pjesëmarrje 29.99% dhe kundravlerën e investimit në shumën prej 31,000,000 Euro (3,109,610 mijë Lek) në kapitalin aksionar të filialit BKT Kosova Sh.a me normë pjesëmarrje 100%.

Kompania Albania Leasing është regjistruar ligjërisht në 2 gusht 2013. Në datën 21 prill 2014 kompania u licensua nga Banka e Shqipërisë e cila nisi aktivitetin e saj në qershor 2014.

BKT hapi degën e saj të parë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë më 3 shtator 2007. Zyra Administrative e kësaj dege u hap në Prishtinë, Kosovë. Banka Qendrore e Kosovës aprovoi më 30 prill 2018 transformimin në filial të Degës së Kosovës të Bankës Kombëtare Tregtare. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Dega e BKT – së në Kosovë do të mbeten të drejta dhe detyrime të BKT Kosova Sh.a. si një filial. Banka Kombëtare Tregtare Sh.a. është aksioneri i vetëm i BKT Kosova Sh.a. Data e shkëputjes së filialit BKT Kosova është efektive nga data 1 janar 2019.

Gjatë vitit 2022, BKT themeloi kompaninë e parasë elektronike "BKT Pay" duke investuar në total 2,300,000 EUR dhe 140,001 Lek në kapitalin e saj aksionar me normë pjesëmarrje 100%. BKT Pay është regjistruar ligjërisht në 26 shtator 2022. Në 3 nëntor 2023 BKT Pay ka marrë licencën nga Banka e Shqipërisë dhe pritet të nisë aktivitetin brenda vitit 2024.

6. Informacion mbi borxhin e varur të Bankës

Borxhi i varur në vlerën 2,516,423 mijë Lek (31 dhjetor 2023: 2,608,154 mijë Lek) përfaqëson kundravlerën e kredisë 10-vjeçare në shumën 25 milionë Euro, me një normë interesi prej 8.893% dhe e pagueshme në datën e maturimit. Borxhi i varur është marrë nga Green for Growth Fund Southeast Europe, në kuadër të marrëveshjes së re për borxhin e varur “Subordinated Term Loan Facility Agreement”, nënshkruar më 22 dhjetor 2015 me synim ofrimin e kredive të lidhura me investime në fushën e Eficiencës Energjitike dhe Energjisë së Rinovueshme.

Në vijim të miratimeve të marra nga Banka e Shqipërisë, borxhi i varur është klasifikuar si kapital shtesë dhe është përfshirë në kapitalin rregullator të Bankës.

7. Informacion mbi sipërmarrjet mëmë dhe sipërmarrjet aksionere kryesore në banka

N/A

8. Informacion i degës së bankës së huaj lidhur me bankën-mëmë

N/A

Aneksi 2

Tabela 2: Bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe në veçanti tregues të rentabilitetit

AKTIVET

(000/ lekë)	30 Qershor 2024	31 Dhjetor 2023	30 Qershor 2023
VEPRIMET ME THESARIN DHE TRANSAKSIONET NDËRBANKARE	97,248,739	91,457,187	96,706,157
Arka dhe Banka Qendrore	40,841,632	47,702,102	40,599,892
Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për rifinancim me Bankën Qendrore	17,962,139	12,890,060	21,637,907
Llogari rrjedhëse në bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	1,170,697	4,771,111	3,675,551
Depozita me bankat, institucionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare	17,858,469	12,086,466	16,270,923
Hua për bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	15,658,936	10,845,553	11,121,276
Llogari të tjera me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	3,756,902	3,161,930	3,400,641
VEPRIMET ME KLIENTËT	96,034,905	94,902,590	86,531,821
Hua standarde dhe paradhënie për klientët	87,479,380	88,506,212	80,185,623
Hua dhe paradhënie të papaguara në afat për klientët	48,155	68,671	272,790
Hua dhe paradhënie në ndjekje	7,312,426	5,431,351	5,008,645
Hua nënstandarde, neto	672,746	670,343	766,049
Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë nënstandarde	(170,442)	(167,911)	(193,222)
Hua të dyshimta, neto	477,758	145,233	180,131
Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë e dyshimta	(518,148)	(145,820)	(181,214)
Hua të humbura, neto	0	0	0
Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë e humbura	(1,784,735)	(2,065,133)	(2,120,532)
Qeveria Shqiptare dhe administrata publike	44,440	80,781	118,583
VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	289,648,500	289,846,231	267,086,294
Letra me vlerë me të ardhura fikse	284,696,705	283,336,181	262,264,365
Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme	1,937,256	2,685,138	2,796,675
MJETE DHE DETYRIME TË TJERA	2,826,670	3,325,683	3,933,467
MJETET E QËNDRUESHME DHE BURIMET E PËRHERSHME	7,197,838	7,133,378	6,519,436
TOTALI	492,956,652	486,665,069	460,777,175

PASIVET

(000/ lekë)	30 Qershor 2024	31 Dhjetor 2023	30 Qershor 2023
VEPRIMET E THESARIT DHE TRANSAKSIONET NDËRBANKARE	15,638,427	18,011,661	24,628,466
Banka Qendrore	896,275	55,113	53,322
Bono thesari dhe bono të tjera të përshtatshme për rifinancim me Bankën Qendrore	4,406,810	7,109,611	12,296,568
Llogari rrjedhëse me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	2,567,471	3,648,749	3,513,376
Depozita nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	7,730,053	7,166,201	8,732,357
Hua marrë nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	0	0	0
VEPRIMET ME KLIENTËT	413,639,465	407,040,034	381,167,797
QEVERIA SHQIPTARE DHE ADMINISTRATA PUBLIKE	3,026,196	3,431,259	2,537,093
Detyrime ndaj klientëve për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat	401,632,925	395,051,045	371,864,492
Llogari të tjera të klientëve	8,980,345	8,557,730	6,766,212
VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	8,770,966	4,227,803	1,065,721
Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes	5,680,199	1,027,036	1,065,721
MJETE DHE DETYRIME TË TJERA	1,770,581	2,537,466	2,604,790
MJETE TË QËNDRUESHME DHE BURIME TË PËRHERSHME	53,137,213	54,848,104	51,310,401
Fondet rezervë specifike	2,209,766	2,997,110	2,746,383
Borxhi i varur	2,516,423	2,608,154	2,671,578
Kapitali i aksionerëve	48,411,024	49,242,840	45,892,440
Kapitali i paguar	38,553,923	33,727,923	33,727,923
Rezerva	7,233,712	6,840,633	6,840,633
Diferenca e rivlerësimit	(5,758,923)	(5,545,923)	(4,282,923)
Fitimi (humbja) i pashpërndarë	4,175,129	6,358,632	6,358,632
Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor	4,207,184	7,861,576	3,248,175
TOTALI	492,956,652	486,665,069	460,777,175

ZËRAT JASHTË BILANCIT

(000/ lekë)	30 Qershor 2024	31 Dhjetor 2023	30 Qershor 2023
ANGAZHIME FINANCIMI	16,179,517	17,099,206	16,144,713
Angazhime të dhëna	16,179,517	17,099,206	16,144,713
GARANCITË	298,958,473	301,042,973	283,284,705
Garanci të dhëna	5,955,367	6,806,365	10,295,027
Garanci të marra	293,003,106	294,236,608	272,989,678
ANGAZHIME PËR LETRAT ME VLERË	18,224,824	16,977,448	24,879,899
TRANSAKSIONE NË VALUTË	8,084,583	14,004,360	26,378,958
ANGAZHIME PËR INSTRUMENTET FINANCIARE	13,099,595	13,565,755	6,981,564
TOTALI	354,546,992	362,689,742	357,669,839

LLOGARIA FITIM E HUMBJE

(000/lekë-kumulativ)	30 Qershor 2024	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023	30 Shtator 2023	30 Qershor 2023
Të ardhura nga interesat	10,746,899	5,281,720	19,662,332	14,570,159	9,613,221
Për veprimet e thesarit dhe ndërbankare	1,073,068	490,428	1,955,432	1,430,061	941,656
Nga veprimet me klientët	2,822,535	1,419,928	5,911,044	4,415,159	2,929,951
Nga veprimet me letrat me vlerë	6,256,561	3,079,033	10,836,458	7,974,596	5,236,407
Amortizimi i skontove të letrave me vlerë	579,982	287,138	944,256	737,814	495,984
Të tjera	14,753	5,194	15,141	12,530	9,223
Shpenzime për interesa	(2,994,242)	(1,439,029)	(5,240,862)	(3,834,988)	(2,550,359)
Për veprimet e thesarit dhe ndërbankare	(47,949)	(22,260)	(153,164)	(129,391)	(109,774)
Për veprimet me klientët	(1,982,277)	(969,210)	(3,096,254)	(2,197,281)	(1,438,582)
Për borxhet e varura	(116,904)	(59,452)	(228,611)	(169,339)	(108,887)
Për letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve të riblerjes	(245,108)	(93,160)	(300,452)	(232,109)	(146,821)
Amortizimi i primeve të letrave me vlerë	(525,536)	(259,332)	(1,441,419)	(1,099,019)	(741,590)
Të tjera	(76,466)	(35,615)	(20,962)	(7,848)	(4,706)
Të ardhurat nga interesat, neto	7,752,657	3,842,690	14,421,470	10,735,171	7,062,861
Të ardhura nga komisione për shërbime bankare	1,337,207	628,458	2,782,882	2,116,592	1,294,027
Nga veprimet e thesarit dhe ndërbankare	39,035	21,085	129,228	112,804	102,855
Nga transaksionet me klientët	686,964	293,209	1,561,130	1,198,409	662,089
Komisione për shërbimet bankare	605,300	310,833	1,080,509	796,245	522,719
Komisione të tjera	5,908	3,331	12,016	9,135	6,365
Shpenzime për komisione	(27,139)	(18,952)	(79,317)	(68,779)	(63,807)
Për veprimet e thesarit dhe ndërbankare	(18,173)	(14,524)	(64,055)	(57,910)	(56,597)
Për transaksionet me klientët	0	0	0	0	0
Komisione për shërbime bankare	(8,966)	(4,428)	(15,261)	(10,869)	(7,210)
Komisione të tjera	0	0	0	0	0
Fitim/Humbje nga komisionet, neto	1,310,068	609,506	2,703,565	2,047,813	1,230,220
Të ardhura të tjera të veprimtarisë bankare	604,779	282,081	2,891,201	1,334,723	1,152,967
Shpenzime të tjera të veprimtarisë bankare	(835,248)	(385,157)	(2,256,194)	(1,692,968)	(1,306,360)
Fitim/Humbje nga veprimtaritë e tjera bankare, neto	(230,469)	(103,076)	635,007	(358,245)	(153,393)
Fitim/Humbje nga veprimet me valutat, neto	395,838	359,684	(728,629)	(170,646)	(597,854)
Totali i të ardhurave operative	9,228,094	4,708,805	17,031,414	12,254,093	7,541,834
Shpenzimet operative					
Shpenzime për personelin	(1,583,687)	(773,017)	(2,887,650)	(2,100,244)	(1,374,880)
Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat	(7,831)	(1,122)	(34,773)	(24,704)	(14,318)
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	(2,240,047)	(1,047,894)	(4,415,063)	(3,229,090)	(2,028,996)
Amortizimi dhe fondet rezervë për zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme	(452,294)	(213,953)	(770,116)	(566,671)	(366,690)
Totali i shpenzimeve operative	(4,283,859)	(2,035,985)	(8,107,603)	(5,920,709)	(3,784,884)
Të ardhura të jashtëzakonshme	35,747	20,883	119,523	83,628	73,255
Shpenzime të jashtëzakonshme	0	0	0	0	0
Fitim/Humbja nga veprimtaritë e jashtëzakonshme	35,747	20,883	119,523	83,628	73,255
Shpenzime për fonde rezervë për huatë	(30,354)	(59,062)	30,025	27,292	(8,823)
Fitim/Humbja para tatimit	4,949,628	2,634,640	9,073,359	6,444,304	3,821,383
Tatimi mbi fitimin	(742,444)	(395,196)	(1,211,783)	(966,646)	(573,207)
Fitim/Humbja e vitit	4,207,184	2,239,444	7,861,576	5,477,659	3,248,175

TREGUESIT E RENTABILITETIT(*)

	30 Qershor 2024	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023	30 Shtator 2023	30 Qershor 2023
1. Kthyesheria nga aktivet mesatare (ROAA) [te ardhurat neto / aktivet mesatare *100]	1.71%	1.82%	1.66%	1.54%	1.37%
2. Rezultati neto i jashtezakonshe / aktivet mesatare	0.01%	0.02%	0.03%	0.02%	0.03%
3. Shpenzimet e pergjithshme te veprimtarise / te ardhurat bruto te veprimtarise	46.49%	43.76%	47.32%	48.01%	50.05%
4. Te ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e pergjithshme te veprimtarise	181.31%	188.84%	178.64%	182.08%	187.32%
5. Kthyesheria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) [te ardhurat neto/kapitali aksioner mesatar *100]	17.26%	18.06%	16.32%	15.21%	13.43%
6. Aktive per punojes [totali i aktiveve/ numri i rregjistruar i punojesve] ne Lek'000	469,493	470,296	452,129	456,959	475,659
7. Te ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare	3.15%	3.12%	3.04%	3.03%	2.98%
8. Te ardhurat nga interesat / aktivet mesatare	4.37%	4.29%	4.14%	4.11%	4.05%
9. Shpenzime per interesa / aktive mesatare	1.22%	1.17%	1.10%	1.08%	1.07%
10. Te ardhurat neto nga interesat / te ardhurat bruto te veprimtarise	84.29%	82.64%	84.53%	87.41%	93.76%
11. Te ardhurat neto nga veprimtarite e tjera / aktivet mesatare	0.81%	0.90%	0.44%	0.50%	0.18%
12. Shpenzimet jo per interesa / te ardhurat bruto te veprimtarise	54.87%	50.99%	63.74%	63.33%	74.96%
13. Shpenzime personeli / te ardhurat bruto te veprimtarise	17.22%	16.62%	16.93%	17.10%	18.25%
14. Shpenzime per provigjone / aktivet mesatare	0.22%	0.24%	-0.12%	0.07%	-0.02%

(*) Normat e mësipërme janë norma vjetore.

Informacioni cilësor (a)

Pasqyra e pozicionit financiar

Totali i aktiveve të bankës në fund të T2 2024 rezultoi në vlerën 493.0 miliardë Lek, duke u rritur me 6.3 miliardë Lek ose 1.3% krahasuar me fundvitin 2023.

Rritja e aktiveve gjatë këtij gjashtëmujori ka ardhur kryesisht si rezultat i efektit të rritjes së zërit të “Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” një rritje me 5.8 miliardë Lek ose 6.3%.

Lëvizjet kryesore në këtë klasë janë nga “Depozita me bankat, institucionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare”, konkretisht depozitat me bankat ndërkombëtare janë rritur me 5.7 miliardë Lek.

Sa i takon të zërit “Veprimet me klientët”, që përfshijnë kreditë dhënë klientëve (neto), rezultoi 96.0 miliardë Lek duke u rritur me 1.2% krahasuar me fundin e vitit.

Norma e kredive me probleme (mbi 90 ditë) ndaj totalit të portofolit të kredisë dhënë klientëve është përkeqësuar me 0.4% krahasuar me fundin e vitit 2023, duke arritur në nivelin 3.7% në fund të muajit Qershor 2024, si rezultat i rritjes të portofolit të kredive me probleme me 0.4 miliardë Lek.

Detyrimet në total u rritën me 8.0 miliardë Lek ose 1.9%, të ndikuara kryesisht nga zëri “Detyrime ndaj klientëve për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat” i cili u rritndjeshëm me 6.6 miliardë Lek ose 1.7% si pasojë e rritjes së veprimeve me “Individët” në monedhën vendase.

Kapitali i aksionerëve në fund të T2 2024 ishte 48.4 miliardë Lek.

Bazuar në vendimin e asamblesë së aksionarëve datë 27.03.2024, Banka realizoi shtesën e kapitalit aksionar në shumën totale prej 4.8 miliardë lek ose 50,000,000.05 USD, që i përkiste një pjese të fitimit të pashpërndarë të vitit 2022. Numri i aksioneve shtesë të emetuara është 4,048,583 me një vlerë nominale prej 12.35 USD për aksion. Pas vendimit të rritjes numri total i aksioneve të Bankës është 28,340,081 aksione.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) në fund të Qershor 2024, rezultoi në nivelin 19.26%, duke pësuar rënie me 79 bps krahasuar me rezultatin e fundit të vitit, si rezultat i efektit të rritjes së aktiveve të ponderuara me risk me 4.5 miliardë Lek (2.0%).

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Fitimi neto i BKT-së për T2 2024, arriti ~4.2 miliardë Lek, duke rezultuar 1.0 miliardë Lek ose 29.5% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të mëparshëm.

Të ardhurat neto nga interesat u rritën me ~0.7 miliardë Lek ose 9.8%. Kjo rezulton nga rritja e të ardhurave nga interesat me 1.1 miliardë Lek dhe rritja e shpenzimeve për interesa me 0.4 miliardë Lek. Rritja e të ardhurave ka ardhur si rezultat i rritjes së të ardhurave nga veprimet me letrat me vlerë me ~1.0 miliardë Lek. Rritja e shpenzimeve ndikohet kryesisht nga veprimet me klientët .

Të ardhurat neto nga komisionet mbeten pothuajse njësoj, duke u rritur me vetëm 0.08 miliardë Lek ose 6.5% krahasuar me T2 2023. Veprimet me valutat neto rezultuan ~1.0 miliardë Lek më shumë se viti i kaluar, duke rregjistruar ~0.4 miliardë Lek fitim.

Provizionet për zhvlerësimin e letrave me vlerë shënuan një rimarrje për këtë T2 2024 në shumën 169.1 milionë Lek.

Shpenzimet operative në fund të gjashtëmujorit të parë janë 4.3 miliardë Lek, duke shënuar 0.5 miliardë Lek ose 13.2% më shumë se T2 2023. Peshën më të madhe në këtë rritje e zënë zërat “Shpenzime personeli” dhe “Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë”, konkretisht rritje kanë pësuar shpenzimet për qera, shpenzimet për pagesën e primit të depozitave dhe shpenzime periodike për kartat.

Treguesit e kthyeshmërisë së aktiveve mesatare (RoAA) dhe të kapitalit aksioner mesatar (RoAE) më 30 Qershor 2024 rezultuan përkatësisht 1.71% dhe 17.26 %, duke treguar 0.1% dhe 0.9% më shumë se fundin e vitit 2023.

Tabela 3: Struktura e kapitalit rregullator

KAPITALI RREGULLATOR PËR MBULIMIN E RREZIQEVE TË KREDISË

(000/ lekë)	30 Qershor 2024	31 Dhjetor 2023
KAPITALI BAZË		
I. Elementet përbërëse që shtohen (A):	42,921,924	43,523,284
II. Elementet përbërëse që zbriten (B):	-	-
Totali Kapitalit Bazë C=(A-B)	42,921,924	43,523,284
KAPITALI SHITESË		
III. Elementet përbërëse (J):	761,685	1,049,954
IV. Elementet përbërëse që zbriten (P+Q+V):	-	-
Totali i kapitalit shtesë	761,685	1,049,954
Totali i kapitalit bazë dhe kapitalit shtesë: E=(JA+CA)	43,683,609	44,573,238

Tabela 4: Mjaftueshmëria e Kapitalit

RAPORTI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

(000/ lekë)	30 Qershor 2024	31 Dhjetor 2023
1. Totali i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun	226,773,356	222,253,922
2. Kapitali rregullator	43,683,609	44,573,238
3. Kapitali bazë i llogaritur	42,921,924	43,523,284
4. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (2/1) *100	19.26%	20.06%
5. Raporti i modifikuar i mjaftueshmërisë së kapitalit (3/1) *100	18.93%	19.58%
6. Raporti minimal i modifikuar	6.75%	6.75%
7. Raporti minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit	12.00%	12.00%

Informacioni cilësor (a)

Mjaftueshmëria e Kapitalit është një faktor kyç në vendosjen e objektivave të investimeve në të ardhmen nga banka. Një pjesë e rëndësishme në llogaritjen e saj është dhe llogaritja e ekspozimeve të ponderuara me rrezik. Bazuar në diversitetin e aktivitetit të BKT-së, procesi i menaxhimit të rreziqeve kalon në disa hapa: identifikimi, vlerësimi, matja, agregimi dhe menaxhimi, si dhe alokimi i kapitalit të bankës nëpër linjat e biznesit.

Llogaritja e mjaftueshmërisë së kapitalit në BKT kryhet bazuar në rregulloren Nr.48 “Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit” dhe rregulloren Nr. 69 “Për Kapitalin Rregullator”.

Rreziku i Kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku që vjen nga mosgatishmëria apo paaftësia e debitorit për të përmbushur kontratat e kredisë, duke çuar në humbje ekonomike për bankën, duke qenë se ajo mund të humbasë si principalin ashtu edhe kolateralin. Ekspozimet të cilat mbartin një rrezik kredie trajtohen bazuar në Metodën Standarte. Metoda Standarte mat rrezikun e kredisë përmes peshave fikse të rrezikut, të cilat janë të paracaktuara nga rregullatori.

Rreziku i Tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes në pozicionin në bilanc dhe jashtë-bilancit si rezultat i ndryshimeve të çmimeve në tregun financiar, duke përfshirë normat e këmbimit valutor, Swap-et dhe të gjitha llojet e transaksioneve të bëra në tregjet financiare ndërkombëtare. Bazuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë, llogaritet kërkesa për kapital për të mbuluar rreziqet e tregut, rrezikun e pozicionit dhe rrezikun e përqëndrimit si dhe kërkesa për kapital për të mbuluar rrezikun e kursit të këmbimit dhe rrezikun e shlyerjes.

Rreziku Operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve që rezultojnë nga procese të brendshme të papërshtatshme ose të dështuara, njerëzit dhe sistemet ose nga ngjarje të jashtme. Ai përfshin rrezikun ligjor, por përjashton rrezikun strategjik dhe atë reputacional. Kërkesa për kapital për rrezikun operacional llogaritet sipas Metodës së Indikatorit Bazë (*Basic Indicator Approach*). Kërkesa për kapital llogaritet bazuar në mesataren e tre viteve të fundit të të ardhurave neto të aktivitetit të bankës, të cilat ponderohen me një koeficient α 15%.

Rreziku i Kredisë së Kundërpartisë

Rreziku i kredisë së kundërpartisë rrjedh nga aktiviteti direkt i bankës i tregimit të derivativëve dhe letrave me vlerë në bursa të ndryshme. Llogaritja e kërkesës për kapital për këtë rrezik, kryhet duke marrë në konsideratë të gjitha ekspozimet në librin e bankës dhe në librin e tregtueshëm. Kërkesa për kapital bazohet në rregulloren e Bankës së Shqipërisë, ku në varësi të llojit të ekspozimit, perdoret një nga dy metodat: metoda e ekspozimit origjinal ose metoda e vlerësimit *mark-to-market*, kryesisht për kontratat e së ardhmes së indekseve ose të kontratave të differences (CFD).

Kapitali Rregullator

Kapitali Rregullator, bazuar në kërkesat e Bankës së Shqipërisë përbehet nga: kapitali i nivelit të parë (Tier 1) dhe kapitali i nivelit të dytë (Tier 2). Kapitali i nivelit të parë është i ndarë në: kapitalin bazë të nivelit të parë dhe kapitalin shtesë të nivelit të parë. Kapitali i nivelit të dytë përfshin instrumenta kapitali, aksionet preferenciale, borxhin e varur si dhe primet e emëtimit të lidhura me instrumentet e sipërpërmendura.

Minimumi i kërkuar për normën e kapitalit bazë të nivelit të parë, për normën e kapitalit të nivelit të parë dhe normën e kapitalin rregullator është i përcaktuar nga kërkesat rregullative të Bankës së Shqipërisë.

Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur vlerat e kërkesës për kapital për secilën prej klasave të aktiveve, të klasifikuara sipas peshës së rrezikut që ato kanë:

NORMA E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT 30 QERSHOR 2024

Klasat e Ekspozimeve (000/ lekë)	Totali i Aktiveve me rrezik (perpara ponderimeve)	Ekspozimet e Ponderuara me Rrezik
I. Rreziku i Kredisë - Asetet e Ponderuara me Rrezik	510,910,335	190,821,934
Asetet pa risk me peshë rreziku 0%	240,581,967	-
Asetet me rrezik të ulët me peshë rreziku 20%	31,859,533	6,309,711
Asetet me peshë rreziku 35%	22,152,084	7,753,230
Asetet me peshë rreziku 50%	62,331,040	30,964,490
Asetet me peshë rreziku 75%	23,357,284	15,213,520
Asetet me peshë rreziku 85%	6,614,217	5,622,084
Asetet me peshë rreziku 100%	101,308,391	88,610,976
Asetet me peshë rreziku 125%	3,143,841	2,623,292
Asetet me peshë rreziku 150%	13,544,576	19,424,499
Asetet me peshë rreziku 250%	5,521,820	13,804,551
Asetet me peshë të tjera rreziku	-	-
Ekspozime Titullzimi	-	-
Rreziku i Kunderpartisë	495,581	495,581
II. Kërkesa për Kapital për Rrezikun e Tregut		9,884,099

Kërkesa për Kapital për Rrezikun e Kursit të Këmbimit		8,602,380
Kërkesa për Kapital për Rrezikun e Pozicionit		1,281,718
Kërkesa për Kapital për Rrezikun e Përqendrimit		-
III. Rreziku Operacional		26,067,324
Metoda e Treguesit të Thjeshtë		26,067,324
IV. Rregullime të kërkuara nga Rregullatori		-
Totali i Klasave të Ekspozimeve (Rreziku i Kredisë, i Tregut, Operacional dhe Rregullimet)		226,773,356
Kapitali Rregullator		43,683,609
Ratio e Mjaftueshmërisë së Kapitalit		19.26%

Mjaftueshmëria e kapitalit

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është raporti i kapitalit rregullator me ekspozimet e ponderuara me rrezikun, llogaritur si totali i vlerave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, si ato në bilanc edhe ato jashtë bilancit, për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, si dhe kërkesat për kapital për rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional.

Minimumi i përqindjes së kapitalit rregullator ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezik që kërkohet nga Banka e Shqipërisë është 12%. Minimumi i treguesit për kapitalin e nivelit të parë është 6% dhe minimumi i treguesit për kapitalin bazë të nivelit të parë është 4.5%.

Në Qershor 2024, BKT ka raportuar normat individuale të mëposhtme:

- Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit 19.26% (Dhjetor 2023: 20.06%);
- Raporti i kapitalit të nivelit të parë 18.93% (Dhjetor 2023: 19.58%);
- Raporti i kapitalit bazë të nivelit të parë 18.93% (Dhjetor 2023: 19.58%).

Tabela 5: Informacion i përgjithshëm mbi ekspozimin ndaj rreziqeve

Grupi i Menaxhimit të Rrezikut është përgjegjës për të identifikuar, matur, monitoruar, parandaluar dhe raportuar aktivitetin e lidhur me menaxhimin e rrezikut të kredisë, rrezikut të tregut, rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional, rrezikut ligjor, përputhshmërisë dhe aktivitetet kundër pastrimit të parave.

Grupi i Menaxhimit të Rrezikut është një funksion që kryen në mënyrë të pavarur aktivitetin e tij nga funksionet e tjera të cilat kryejnë biznes dhe marrin përsipër rrezik.

Bazuar në aktivitetin e Grupit të Menaxhimit të Rrezikut, është hartuar Politika e Menaxhimit të Rreziqeve, e cila përcakton qartë modelin e mbrojtjes së bankës, nivelin e pranuar të rrezikut si dhe parimet e menaxhimit të rrezikut në BKT.

Banka operon bazuar në modelin e tri linjave të mbrojtjes të manaxhimit të rreziqeve. Në Linjën e parë të mbrojtjes janë përfshirë të gjitha njësitë e linjave të biznesit të cilat janë dhe burimi i rreziqeve. Linja e dytë e mbrojtjes është një funksion i pavarur i manaxhimit dhe kontrollit të rreziqeve. Linja e tretë e mbrojtjes është Grupi i Auditit të Brendshëm, i cili mundëson efektivitetin dhe eficiencyn e kontrollit të bankës. Të trija linjat e mbrojtjes janë të pavarura nga njera tjetra dhe arrijnë të mundësojnë që të respektohen principet e Bankës në të gjitha nivelet e saj.

Grupi është i përbërë nga 5 departamente, të cilat janë përgjegjëse për të ndërmarrë veprimet dhe për të kryer detyrat e duhura dhe përmbushjen e qëllimeve të Grupit. Në mënyrë specifike, departamentet janë: Departamenti i Risqeve të Kreditit, Departamenti i Riskut Operacional dhe Mashtrimit, Departamenti i Vlerësimit të Kredive, Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Departamenti i Risqeve të Tregut i cili raporton direkt në Komitetin e Manaxhimit të Rreziqeve.

Politikat dhe procedurat e manaxhimit të rrezikut janë hartuar me qëllim që të përcaktojnë mënyrën e identifikimit dhe analizimit të rreziqeve me të cilat përballë banka, të vendosin mjete kontrolli të përshtatshme për rreziqet, si dhe të përcaktojnë mënyrën e kontrollit, monitorimit dhe përmbajtjes me limitet e përcaktuara. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të rrezikut rishikohen në mënyrë periodike me qëllim përditësimin e tyre me teknikat më të fundit identifikuese dhe analizuese dhe zhvillimin e aktivitetit të bankës dhe përfshirjen e burimeve të reja të rrezikut.

Grupi raporton në mënyrë periodike tek Drejtori Ekzekutiv i Bankës, strukturat monitoruese dhe Këshilli Drejtues.

Shpërndarja e kredisë sipas qëllimit të përdorimit të kredisë (000/lekë)	Teprica mesatare bruto e kredisë gjatë periudhës tremujore	Interesi i përlogaritur
Korporata jofinanciare publike	3,218,932	942
ALL	3,218,932	942
Overdraft	2,856,996	-
Kapital qarkullues	-	-
Blerje pajisjesh	-	-
Pasuri të paluajtshme	361,937	942
Hua të tjera	-	-
USD	-	-
Overdraft	-	-
Kapital qarkullues	-	-
Blerje pajisjesh	-	-
Pasuri të paluajtshme	-	-
Hua të tjera	-	-

EUR	-	-
Overdraft	-	-
Kapital qarkullues	-	-
Blerje pajisjesh	-	-
Pasuri të paluajtshme	-	-
Hua të tjera	-	-
Të tjera monedha	-	-
Overdraft	-	-
Kapital qarkullues	-	-
Blerje pajisjesh	-	-
Pasuri të paluajtshme	-	-
Hua të tjera	-	-
Korporata jofinanciare private	34,650,167	301,043
ALL	13,360,292	67,061
Overdraft	2,251,250	56
Kapital qarkullues	1,545,560	5,724
Hua për çelje biznesi	6,812,118	47,252
Blerje pajisjesh	208,418	1,005
Pasuri të paluajtshme	2,542,946	13,024
Hua për investime në instrumenta financiare	-	-
USD	902,343	31,965
Overdraft	2	-
Kapital qarkullues	-	-
Hua për çelje biznesi	-	-
Blerje pajisjesh	-	-
Pasuri të paluajtshme	902,341	31,965
Hua për investime në instrumenta financiare	-	-
EUR	20,387,532	202,018
Overdraft	1,491,301	-
Kapital qarkullues	1,519,733	43,572
Hua për çelje biznesi	552,803	1,579
Blerje pajisjesh	60,415	171
Pasuri të paluajtshme	16,763,281	156,696
Hua për investime në instrumenta financiare	-	-
Të tjera monedha	-	-
Overdraft	-	-
Kapital qarkullues	-	-
Hua për çelje biznesi	-	-
Blerje pajisjesh	-	-
Pasuri të paluajtshme	-	-
Hua për investime në instrumenta financiare	-	-

Individë + Institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	54,503,097	159,073
ALL	43,204,379	135,438
Overdraft	1,983,499	2,372
Mallra jo të qëndrueshëm	5,679,188	27,916
Mallra të qëndrueshëm	1,368,369	4,067
Hua për blerje banesash	31,597,194	90,162
Hua për qëllime të tjera	2,576,129	10,921
<i>nga të cilat: për të vetëpunësuarit</i>	1,086,414	5,104
USD	1,514	4
Overdraft	68	-
Mallra jo të qëndrueshëm	-	-
Mallra të qëndrueshëm	748	2
Hua për blerje banesash	-	-
Hua për qëllime të tjera	698	2
<i>nga të cilat: për të vetëpunësuarit</i>	-	-
EUR	11,297,204	23,631
Overdraft	11,438	-
Mallra jo të qëndrueshëm	19,161	58
Mallra të qëndrueshëm	774,953	1,655
Hua për blerje banesash	9,371,081	16,648
Hua për qëllime të tjera	1,120,571	5,270
<i>nga të cilat: për të vetëpunësuarit</i>	257,235	740
Të tjera monedha	-	-
Overdraft	-	-
Mallra jo të qëndrueshëm	-	-
Mallra të qëndrueshëm	-	-
Hua për blerje banesash	-	-
Hua për qëllime të tjera	-	-
<i>nga të cilat: për të vetëpunësuarit</i>	-	-
Totali	92,372,196	305,579

Tabela 6: Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm

Ekspozimet ndaj Rreziqeve dhe Vlerësimi i Tyre

Rreziku i kredisë

Administrimi i rrezikut financiar

Instrument financiar është çdo kontratë që të jep të drejtën të marrësh para ose një aktiv tjetër financiar nga një palë tjetër (aktiv financiar) ose të detyron të transferosh para ose një aktiv tjetër financiar tek një palë tjetër (detyrim financiar).

Instrumentat financiare e ekspozojnë Bankën ndaj një sërë risqesh. Risqet më të rëndësishme me të cilat përballet Banka janë rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit dhe rreziku i tregut. Rreziku i tregut përfshin rrezikun e monedhës të huaj, rrezikun e normës së interesit dhe rrezikun e çmimeve të tjera.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës nëse një klient ose kundërpartia e një instrumenti financiar dështon të shlyejë detyrimet e tij kontraktuale, dhe vjen kryesisht nga huatë dhe paradhëniet e Bankës ndaj klientëve dhe bankave të tjera dhe investimeve në letra me vlerë. Për qëllime të raportimit në manaxhimin e rrezikut, Banka i merr në konsideratë të gjithë elementët e ekspozimit të rrezikut të kredisë (si rreziku i dështimit individual, i vendit dhe sektorit). Banka ka krijuar një Komitet Krediti për mbikëqyrjen e miratimin e kërkesave për kredi. Kërkesat për kredi për shuma mbi 2,000,000 Euro aprovohen me vendim të Këshillit Drejtues të Bankës. Ka fokusim të vazhdueshëm mbi cilësinë e huave, si në kohën e aprovimit, ashtu edhe gjatë gjithë jetëgjatësisë së tyre.

KLASIFIKIMI I PORTOFOLIT TË KREDIVE SIPAS SHPËRNDARJES GJEOGRAFIKE (1)

(000/ lekë)	Rrethi Tiranë	Rrethi Durrës	Rrethi Elbasan	Rrethi Shkodër	Rrethi Korcë	Rrethi Vlorë	Rrethi Lushnjë	Rrethi Gjirokastrë	Rrethi Fier
HUA_AFATSHKURTER	7,930,680	827,800	156,789	73,681	125,387	338,391	320,301	24,065	63,787
ALL	6,861,290	239,021	150,426	69,265	112,893	121,176	320,230	24,065	63,787
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Qeveria lokale	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Banka qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Bankat	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shoqëritë e Kursim Kreditit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata të tjera financiare (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit)	1,003,590	-	-	-	-	-	-	-	-
Shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata jofinanciare publike	2,713,143	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata jofinanciare private	1,789,812	88,911	19,886	359	74,335	27,172	303,147	21	24,116
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	1,354,745	150,110	130,540	68,906	38,558	94,003	17,082	24,043	39,672
VALUTE	1,069,391	588,778	6,362	4,415	12,495	217,215	71	-	-
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Qeveria lokale	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Banka qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Bankat	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shoqëritë e Kursim Kreditit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata të tjera financiare (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit)	1,793	-	-	-	-	-	-	-	-
Shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata jofinanciare private	1,042,472	584,819	5,534	663	164	177,706	71	-	-
Individët dhe institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	25,126	3,960	828	3,752	12,331	39,509	-	-	-

KLASIFIKIMI I PORTOFOLIT TË KREDIVE SIPAS SHPËRNDARJES GJEOGRAFIKE (2)

(000/ lekë)	Rrethi Tiranë	Rrethi Durrës	Rrethi Elbasan	Rrethi Shkodër	Rrethi Korcë	Rrethi Vlorë	Rrethi Lushnjë	Rrethi Gjirokastrë	Rrethi Fier
HUA_AFATMESME	8,425,779	1,212,657	469,547	307,261	389,532	416,831	136,415	78,413	184,148
ALL	6,705,934	662,465	447,374	292,973	301,915	336,407	103,622	78,413	179,206
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Qeveria lokale	-	-	39,384	-	-	-	-	-	-
Banka qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Bankat	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shoqëritë e Kursim Kreditit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata të tjera financiare (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit)	2,581,423	-	-	-	-	-	-	-	-
Shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata jofinanciare private	781,293	78,579	26,102	13,058	60,608	84,055	3,216	-	19,889
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	3,343,218	583,886	381,888	279,914	241,307	252,352	100,406	78,413	159,317
VALUTE	1,719,844	550,192	22,173	14,288	87,618	80,424	32,793	-	4,941
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Qeveria lokale	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Banka qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Bankat	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shoqëritë e Kursim Kreditit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata të tjera financiare (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit)	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata jofinanciare private	1,512,937	404,004	-	-	-	52,071	-	-	-
Individët dhe institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	206,908	146,189	22,173	14,288	87,618	28,353	32,793	-	4,941

KLASIFIKIMI I PORTOFOLIT TË KREDIVE SIPAS SHPËRNDARJES GJEOGRAFIKE (3)

(000/ lekë)	Rrethi Tiranë	Rrethi Durrës	Rrethi Elbasan	Rrethi Shkodër	Rrethi Korcë	Rrethi Vlorë	Rrethi Lushnjë	Rrethi Gjirokastrë	Rrethi Fier
HUA_AFATGJATE	58,272,181	2,903,726	1,532,161	1,332,439	980,460	2,184,482	358,050	357,059	1,157,671
ALL	31,982,731	2,023,920	1,341,515	1,187,142	903,851	1,858,628	338,854	357,059	1,070,561
Qeveria qendrore	5,055	-	-	-	-	-	-	-	-
Qeveria lokale	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Banka qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Bankat	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shoqëritë e Kursim Kreditit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata të tjera financiare (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit)	230,730	-	45,824	-	-	-	12,051	-	-
Shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata jofinanciare publike	350,903	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata jofinanciare private	8,967,665	11,097	224,204	40,473	93,278	172,095	14,341	1,380	17,279
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	22,428,377	2,012,823	1,071,487	1,146,669	810,573	1,686,533	312,461	355,679	1,053,282
VALUTE	26,289,451	879,806	190,646	145,296	76,609	325,854	19,196	-	87,110
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Qeveria lokale	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Banka qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Bankat	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shoqëritë e Kursim Kreditit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata të tjera financiare (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit)	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korporata jofinanciare private	17,840,968	46,057	52,275	-	-	27,414	-	-	-
Individët dhe institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	8,448,483	833,749	138,370	145,296	76,609	298,440	19,196	-	87,110
Totali	74,628,641	4,944,182	2,158,497	1,713,380	1,495,380	2,939,703	814,766	459,537	1,405,606

Banka llogarit kërkesën për kapital për rrezikun e kredisë bazuar në Rregulloren Nr. 48, datë 31.07.2013 “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”. Vlerësimi i kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë llogaritet sipas metodës standarde të përcaktuar në këtë rregullore. Banka pasi klasifikon çdo ekspozim të zërave, brenda dhe jashtë bilancit, llogarit klasat e ekspozimit pas zbritjes së fondeve kapital për mbulimin e humbjeve dhe në bazë të peshës së rrezikut të seciles klasë ekspozimi përcaktohet dhe kërkesa për kapital për rrezikun e kredisë. Bazë për përcaktimin e ekspozimeve sipas klasave të përcaktuara në rregullore, janë tipi i kredisë, qëllimi i financimit me kredi, lloji i pronës lënë si kolateral për sigurimin e kredisë, si dhe pronësia e kolateralit. Për Qershor 2024, Banka ka llogaritur kërkesën për kapital për rrezikun e kredisë sipas tabelës më poshtë:

Klasat e ekspozimeve për Rrezikun e Kredisë (000/leke)	Totali i Aktiveve me rrezik (perpara faktoreve të konvertimit dhe ponderimeve)	Ekspozimet e Ponderuara me Rrezik
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore	261,100,669,023	24,250,751,040
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumepaleshe te zhvillimit	0	0
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj insitucioneve te mbikqyrura	104,181,067,685	52,305,896,281
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare	0	0
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	39,384,480	7,876,896
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare	0	0
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	52,590,436,134	44,341,038,745
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail)	26,486,132,729	17,836,811,782
Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme	41,741,569,480	21,063,740,368
Ekspozime (kredi) me probleme	1,150,501,312	1,159,941,030
Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara	0	0
Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK	0	0
Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë	10,648,739,622	15,874,347,824
Ekspozime në zëra të tjerë	12,971,834,346	13,981,529,061
Totali (*)	510,910,334,812	190,821,933,027

(*) Totali i tabelës së mësipërme nuk kuadron me totalin e Rrezikut Të Kredisë - Asetet e Ponderuara me Rrezik (fq. 15) sepse në tabelën më lart nuk janë përfshirë zerat: “Ekspozime Titullzimi” dhe “Rreziku i Kunderpartise”.

Tabela 8: Teknikat e zbutjes së rrezikut

Banka llogarit vlerën e ekspozimit, në rastet kur ky ekspozim është subjekt i mbrojtjes së financuar të kredisë, duke konsideruar teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë, dhe më specifikisht - mbrojtjen e financuar të kredisë, në përputhje me kreun IV të rregullores Nr. 48, datë 31.07.2013 “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”. Per qëllime të llogaritjes së shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, për rrezikun e kredisë, gjatë zbatimit të metodës gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar Banka merr në konsideratë mospërputhjet midis maturitetit të ekspozimit dhe atij të kolateralit financiar, mospërputhjen e monedhave si dhe rregullojnë luhatshmërinë e vlerës së kolateralit, me rezultatet e mëposhtme:

Klasat e ekspozimeve për Rrezikun e Kredisë dhe Kundërpartisë (000/lekë)	Totali i Aktiveve me rrezik (perpara faktoreve të konvertimit dhe ponderimeve)	Metodat e zbutjes së rrezikut të kredisë: Mbrojtja e financuar e kredisë, Metoda gjithëpërfshirëse e kolateralit financiar	Vlera e ekspozimit total pas aplikimit të metodave të zbutjes së rrezikut të kredisë
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore	261,100,669,023	-	261,100,669,023
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpaleshe të zhvillimit	-	-	0
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj insitucioneve të mbikqyrura	104,181,067,685	5,248,130,475	98,932,937,210
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	39,384,480	-	39,384,480
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare	0	-	0
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	52,590,436,134	583,555,806	52,006,880,328
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail)	26,486,132,729	1,914,516,086	24,571,616,643
Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme	41,741,569,480	0	41,741,569,480
Ekspozime (kredi) me probleme	1,150,501,312	177,747	1,150,323,565
Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë	10,648,739,622	1,346,617,358.02	9,302,122,264
Ekspozime ne zera të tjere	12,971,834,346	-	12,971,834,346
Totali	510,910,334,812	9,092,997,473	501,817,337,340

Tabela 9: Rreziku i kredisë së kundërpatisë

Banka, për të mbrojtur disa aspekte të aktivitetit me luhatshmëri të lartë dhe realizimin e fitimeve, ka investuar në tre tipe instrumentesh derivative mbi banak (OTC). Specifikisht këto instrumente janë:

- i- *Swap*-et e monedhës;
- ii- Kontrata të së ardhmes që kanë të bëjnë me titujt ose indekset në tituj;
- iii- Kontrata financiare të diferencave.

Këto instrumenta administrohen sipas përcaktimeve në Rregulloren Nr. 48, “Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”, kreu VI Rreziku i kredisë së kundërpatisë. Sipas kësaj rregulloreje, vlera e ekspozimit të këtyre instrumentave llogaritet duket përdorur një nga dy metodat e mëposhtme:

- a) Metodën e ekspozimit original për *swap*-et e monedhës;
- b) Metodën e market-to-market për kontratat e së ardhmes mbi indekset në tituj dhe kontrata financiare të diferencave (CFD).

Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur vlerat e kërkesës për kapital për secilën prej klasave të aktiveve, të cilat mbartin rrezik kredie të kundërpatisë:

Rreziku i Kundërpatisë (000/leke)	30 Qershor 2024
Klasat e Ekspozimeve	Ekspozimet e Ponderuara me Rrezik
Ekspozime me Institucionet e Mbikqyrura	495,581
Kërkesa për Kapital për Rrezikun e Kundërpatisë	495,581

Tabela 10: Titullzimi

Banka ka hartuar politikë të qartë për mënyrën e tregtimit, monitorimit, kontrollit dhe politikat kontabël për operacionet e titullzimit. Aktualisht, BKT-ja është e ekspozuar në një operacion titullzimi, ku është në rolin e investitorit në një skemë titullzimi.

I. Rreziku i Kredisë (000/leke)	ECAI i Njohur
A. Klasat e ekspozimit	
Ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi (securitization)	Moody's; Fitch; S&P
- Emek Asset Fund	Na

Në tabelën e mëposhtme, janë dhënë ekspozimet që ka Banka në Titullzim:

Ekspozimi ne Titullzim 30.06.2024 (000/leke)	Ekspozimi Total
Ekspozimi Total	-
Kërkesa për kapital në Titullzim	-

Tabela 11: Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm

Vlerësimi i kërkesës për kapital për rrezikut e tregut llogaritet bazuar në Rregulloren Nr. 48, “Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”, kreu VII Rreziku i Tregut. Në përputhje me rregulloren dhe bazuar në strukturën e librit të bankës dhe librit të tregtueshëm, Banka llogarit kërkesën për kapital për rrezikun e tregut si shumë të:

- a) Kërkesës për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm, nëse plotësohen kriteret sipas shënimit më poshtë:
 - i. Kërkesën për kapital për rreziqet e pozicionit;
 - ii. Kërkesën për kapital për rrezikun e përqendrimit.

- b) Kërkesës për kapital rregullator për të gjitha pozicionet e bankës (pozicione në librin e tregtueshëm dhe pozicione në librat e bankës), e cila përfshin:
 - i. Kërkesën për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit;
 - ii. Kërkesën për kapital për rrezikun e shlyerjes.

Shënim: Banka llogarit kërkesë për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm, siç specifikohet në kreun III të rregullores, në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) Gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit, raporti i vlerës mesatare kontabël të librit të tregtueshëm ndaj totalit të aktivitetit nuk është më i lartë se 5%. Në asnjë kohë ky raport nuk është më i lartë se 6%;
- b) Gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit, vlera mesatare kontabël e librit të tregtueshëm nuk është më e lartë se 15 milionë euro. Në asnjë kohë kjo vlerë nuk është më e lartë se 20 milionë Euro.

Rreziqet e Tregut (000/leke)	30.06.2024	
	Kërkesa për kapital	Ekspozimi i ponderuar me rrezik (Kërkesa për kapital *12.5)
Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut	790,728	9,884,099
Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e shlyerjes	-	-
Rreziku i shlyerjes në librin e bankës	-	-
Rreziku i shlyerjes në librin e tregtueshëm	-	-
Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit dhe mallrave (SA)	790,728	9,884,099
Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit	102,537	1,281,718
Rreziku i pozicionit të instrumentave të kapitalit	-	-
Rreziku i kursit të këmbimit	688,190	8,602,380
Rreziku i investimeve në mallra	-	-

Tabela 12: Rreziku operacional

Vlerësimi i kërkesës për kapital për rrezikut operacional llogaritet bazuar në Rregulloren Nr. 48, “Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”, kreut VIII Rreziku Operacional, sipas metodës së treguesit bazik të përcaktuar në këtë rregullore. Sipas kësaj metode, kërkesa për kapital llogaritet si mesatarja e tre viteve të fundit të të ardhurës neto, sipas çdo periudhe raportuese. Kërkesa për kapital është bazuar në të ardhurën neto të viteve 2024, 2023 dhe 2022 dhe një koeficienti α prej 15%.

Rreziku Operacional (000/leke)	30.06.2024	
	Kërkesa për kapital	Ekspozimi i ponderuar me rrezik (Kërkesa për kapital *12.5)
Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	2,085,386	26,067,324
Metoda e Treguesit Bazik (BIA)	2,085,386	26,067,324

Tabela 13: Ekspozimet në instrumenta të kapitalit: informacion mbi pozicionet e përfshira në librin e bankës

N/A

Tabela 14: Rreziku i normës së interesit në librin e bankës

Banka ka ndërtuar sistemin e menaxhimit të rrezikut të normës së interesit bazuar në Udhëzimin Nr. 33, “Mbi Administrimin e Rrezikut të Normës së Interesit në Librin e Bankës”, në politikën e miratuar së brendshmi mbi “Menaxhimin e Rreziqeve të Tregut” si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, Udhëzimi i Komitetit të Basel, Qershor 2004. Politika e menaxhimit të rrezikut të tregut përcakton autoritetet dhe funksionet e përfshira në procesin e menaxhimit të normës së interesit, duke specifikuar gjithashtu ndarjen dhe pavarësinë midis funksioneve të biznesit, operationale dhe të monitorimit e kontrollit. Politika është aprovuar dhe rishikohet periodikisht nga Këshilli Drejtues.

Burimet kryesore të lidhura me rrezikun e normës së interesit vlerësohen:

- i- rreziku i riçimit;
- ii- rreziku i kurbës së kthimit (*yield*);
- iii- rreziku bazë, dhe
- iv- rreziku i opsioneve.

Ndryshimi i normave të interesit mund të ndikojë në të ardhurat e bankës dhe në vlerën ekonomike të aktiveve dhe pasiveve të bankës. Me qëllim matjen e efektit të një ndryshimi të mundshëm të normave të interesit në të ardhurat e bankës, llogaritet vlera e ekspozimit të bankës ndaj rrezikut të normës së interesit, duke zbatuar kriteret dhe supozimet si më poshtë:

- a) Analizohen në mënyrë specifike ato monedha të cilat përbëjnë të paktën 5% të totalit të aktivitetit, pra ALL, EUR dhe USD. Monedhat e tjera analizohen në mënyrë të agreguar;
- b) Në analizë konsiderohen aktivet dhe pasivet, brenda dhe jashtë bilancit, që janë të ndjeshme ndaj normës së interesit;
- c) Aktivet dhe pasivet e ndjeshme ndaj normës së interesit shpërndahen në intervale kohore bazuar në afatin e maturimit për aktivet dhe pasivet që kanë një normë fikse interesi dhe sipas datës së riçimit për ato që kanë një normë të ndryshueshme interesi. Për disa nga zërat më të rëndësishëm të aktiveve ose pasiveve që nuk përfshihen në dy kategoritë e mësipërme, shpërndarja bëhet si më poshtë:

- a. Rezerva e detyrueshme në Lek pranë Bankës së Shqipërisë raportohet në intervalin kohor “deri në 1 muaj”, ndërsa rezerva e detyrueshme në monedhë të huaj konsiderohet si pozicion jo i ndjeshëm ndaj rrezikut të normës së interesit;
- b. Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat, në pasiv të bilancit, shpërndahen si më poshtë:
 - a) 25% e llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat raportohen në intervalin kohor “at sight” (menjëherë/pa afat);
 - b) Pjesa tjetër, 75% shpërndahen në mënyrë proporcionale me numrin e muajve që përmbajnë intervalet kohore nga “deri në 1 muaj” në “4-5 vjet”;
- c. Kreditë me problem raportohen në intervalin kohor “2-3 vjet”.
- d) Ndjeshmëria e të gjithë pozicioneve në librin e bankës ndaj luhatshmerise së normave të interesit vlerësohet duke zbatuar një *shock* të normës së interesit prej 200 pikësh bazë në kohëzgjatjen e modifikuar të çdo intervali kohor.

Analiza e ndryshimit të ekspozimit në librin e bankës me qëllim të matjes së rrezikut të normës së interesit kryhet dhe raportohet në baza tremujore.

Rreziku i Normës së Interesit – Ndryshimi i Vlerës së Ekspozimit (000/leke)	Totali i pozicioneve të ponderuara
Pozicionet e ponderuara neto ne monedhen ALL– (FIR+VIR)	1,375,348
Pozicionet e ponderuara neto ne monedhen USD - (FIR+VIR)	1,513,996
Pozicionet e ponderuara neto ne monedhen EUR - (FIR+VIR)	1,080,581
Pozicionet e ponderuara neto ne monedhat e tjera (GBP, CAD, AUD, CHF, TRY) - (FIR+VIR)	16,412
Ndryshimi ne vleren e ekspozimit	3,986,336
Kapitali rregullator	43,683,609
(Ndryshimi ne vleren e ekspozimit / kapitali rregullator) * 100	9.13%

Tabela 15: Rreziku likuiditetit

Banka ka ndërtuar sistemin e menaxhimit të rrezikut të likuiditeti bazuar në Rregulloren Nr. 71, “Për Administrimin e Rrezikut të Likuiditetit” dhe në politikën e miratuar së brendëshmi mbi “Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit”. Politika e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit përcakton autoritetet dhe funksionet e përfshira në procesin e menaxhimit të likuiditetit, duke specifikuar gjithashtu ndarjen dhe pavarësinë midis funksioneve të biznesit, operacionale dhe të monitorimit e kontrollit. Politika është aprovuar dhe rishikohet periodikisht nga Këshilli Drejtues dhe përgjegjësia i përket Komitetit të Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO).

Situata e likuiditetit monitorohet në baza ditore duke kontrolluar nivelin e aktiveve likuide ndaj pasiveve që maturohen për 12 muaj, si dhe ecurinë e flukseve (kumulative) hyrëse dhe dalëse, sipas supozimeve të përcaktuara së brendëshmi. Supozimet e brendshme të bankës marrin në konsiderate afatet kontraktuale të zërave të bilancit, sjelljen historike të klientëve të bankës në lidhje me shlyerjen e detyrimeve dhe rinovimin e depozitave dhe mundësinë e letrave më vlerë për tu konvertuar apo për të gjeneruar likuiditet.

Norma e Likuiditetit_Qershor 2024

Aktivitet Likuide - Pasivet Afatshkurtra (000/leke)	ALL	Monedha të huaja	Totali
Totali i Aktiveve Likuide	104,840,618	56,962,725	161,803,342
Totali i Pasiveve Afatshkurtra me afat te mbetur maturimi deri ne 1 vit	166,813,847	198,190,395	365,004,242
Ratio e Likuiditetit (në %)	62.85%	28.74%	44.33%
Limiti i lejuar	15.00%	20.00%	20.00%

AKTIVET SIPAS MATURIMIT TË MBETUR

(000/ lekë)	Dite				Muaj			Vite		
	1 (O/N)	2-7	8-15	16-30	1-3	3-6	6-12	1-5	> 5	Totali
VEPRIME ME THESARIN DHE NDËRBANKARE	12,865,063	8,935,739	23,009	41,611,037	2,271,944	4,007,256	21,125,308	5,027,673	1,381,746	97,248,775
Arka	4,028,472	-	-	-	-	-	-	-	-	4,028,472
Llogari rrjedhëse në bankën qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Rezerva të detyrueshme	-	-	-	36,813,160	-	-	-	-	-	36,813,160
Depozita në bankën qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Hua për bankën qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogari të tjera në bankën qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Bono thesari	4,998	-	-	1,300,154	1,097,183	1,314,515	14,245,288	-	-	17,962,139
Bono të tjera të pranueshme për refinancim me bankën qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogari rrjedhëse në institucione financiare rezidente	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogari rrjedhëse në institucione financiare jo rezidente	-	-	-	1,170,697	-	-	-	-	-	1,170,697
Depozita në institucione financiare rezidente	-	45,017	-	95,581	-	-	-	-	-	140,598
Depozita në institucione financiare jo rezidente	8,829,518	8,888,353	-	-	-	-	-	-	-	17,717,871
Hua për institucione financiare rezidente	2,074	2,368	23,009	110,772	259,088	513,240	1,834,018	1,093,707	35,129	3,873,406
Hua për institucione financiare jo rezidente	-	-	-	1,010,581	915,672	2,179,502	2,399,193	3,933,965	1,346,617	11,785,530
Llog. të tjera në institucione financiare	-	-	-	1,110,093	-	-	2,646,809	-	-	3,756,902
VEPRIMET ME KLIENTËT	712,919	507,186	180,901	1,477,758	1,887,535	2,952,952	13,007,281	35,911,171	41,826,086	98,463,790
Hua standarte	36,127	303,261	178,417	1,402,764	1,623,560	2,414,238	11,992,476	29,034,919	40,541,774	87,527,535
- linje kredie	-	-	2,651	202	31,074	10,445	90,364	-	-	134,735
- kredi me keste	36,127	303,261	175,766	1,402,562	1,592,486	2,403,793	11,902,112	29,034,919	40,541,774	87,392,800
Hua në ndjekje	676,793	203,926	2,484	74,994	263,975	538,714	1,014,805	3,817,653	719,082	7,312,426
- linje kredie	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
- kredi me keste	676,793	203,926	2,484	74,994	263,975	538,714	1,014,805	3,817,653	719,082	7,312,426
Hua nënstandard	-	-	-	-	-	-	-	559,473	283,715	843,188
Hua të dyshimta	-	-	-	-	-	-	-	893,433	102,474	995,906
Hua të humbura	-	-	-	-	-	-	-	1,605,693	179,041	1,784,735
Llogari të tjera të klientëve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

VEPRIME ME ADMINISTRATËN PUBLIKE	-	-	-	3,032	5,746	6,727	8,261	13,349	7,325	44,440
Llogari rrjedhëse	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kredi	-	-	-	3,032	5,746	6,727	8,261	13,349	7,325	44,440
Llogari të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TRANSAKSIONE TË LETRAVE ME VLERË	3,014,539	4,464,776	-	23,345,089	11,464,410	18,415,939	38,070,979	145,643,887	50,388,282	294,807,903
Letra me vlerë me të ardhura fikse (BONDE)	-	4,464,776	-	23,345,089	11,464,410	18,415,939	35,917,855	145,643,887	50,388,282	289,640,240
Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	2,153,125	-	-	2,153,125
Letra me vlerë të blera sipas marrëveshjes së rishitjes REPO	3,014,539	-	-	-	-	-	-	-	-	3,014,539
Të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
ASETE TË TJERA	-	-	-	1,359,087	-	-	4,897,461	2,992,693	4,205,146	13,454,386
I-TOTALI I AKTIVEVE	16,592,521	13,907,701	203,910	67,796,004	15,629,635	25,382,875	77,109,291	189,588,773	97,808,584	504,019,294
II- Zerat jashte bilancit	-	631,696	-	1,394,121	-	10,275	15,873,881	2,006,200	-	19,916,172
-Angazhime financiare te dhena kliente (pjesë e paperdorur e linjave te kredise)	-	-	-	-	-	-	15,568,246	-	-	15,568,246
-Angazhime financiare te dhena Institucione te krediti (pjesë e paperdorur e linjave te kredise)	-	-	-	-	-	-	305,636	-	-	305,636
- fonde (valute + leke) e blere ne afat	-	631,696	-	1,394,121	-	10,275	-	2,006,200	-	4,042,291
TOTAL (I+II)	16,592,521	14,539,397	203,910	69,190,125	15,629,635	25,393,150	92,983,172	191,594,973	97,808,584	523,935,467

PASIVET SIPAS MATURIMIT TË MBETUR

(000/ lekë)	Dite				Muaj			Vite		TOTALI
	1 (O/N)	2-7	8-15	16-30	1-3	3-6	6-12	1-5	> 5	
VEPRIMET ME INSTITUCIONET FINANCIARE	1,490,399	8,627,742	-	-	235,860	-	2,964,622	2,319,804	-	15,638,427
Llogari rrjedhëse të bankës qendrore	-	896,275	-	-	-	-	-	-	-	896,275
Depozita të marra nga banka qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Huamarrje nga banka qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogari të tjera me bankën qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Bono thesari të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes REPO	-	4,362,220	-	-	44,590	-	-	-	-	4,406,810
Bono të tjera të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes REPO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogari rrjedhëse të institucioneve financiare rezidente	-	2,238,480	-	-	-	-	-	-	-	2,238,480
Llogari rrjedhëse të institucioneve financiare jo rezidente	-	328,992	-	-	-	-	-	-	-	328,992
Depozita të marra nga institucionet financiare rezidente	1,490,399	801,776	-	-	191,270	-	2,964,622	2,281,985	-	7,730,053
Depozita të marra nga institucionet financiare jorezidente	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Huamarrje nga institucionet financiare rezidente	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Huamarrje nga institucionet financiare jorezidente	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogari të tjera të institucioneve financiare	-	-	-	-	-	-	-	37,818	-	37,818
VEPRIME ME KLIENTËT	702	207,962,894	3,092,272	9,188,474	44,975,951	35,337,477	51,356,748	55,081,445	3,617,306	410,613,270
Llogari rrjedhëse	-	148,624,067	-	-	-	-	-	-	-	148,624,067
Llogari depozitash pa afat	-	47,186,022	-	-	-	-	-	-	-	47,186,022
Llogari depozitash me afat	702	3,337,695	3,092,272	9,188,474	44,975,951	35,337,477	51,258,458	55,014,499	3,617,306	205,822,835
Certifikata depozitash	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogari të tjera të klientëve	-	8,815,110	-	-	-	-	98,290	66,945	-	8,980,345
VEPRIME ME ADMINISTRATEN PUBLIKE	-	3,026,196	-	-	-	-	-	-	-	3,026,196



BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Llogari rrjedhëse	-	525,077	-	-	-	-	-	-	-	525,077
Llogari depozitash pa afat	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogari depozitash me afat	-	2,501,119	-	-	-	-	-	-	-	2,501,119
Hua të marra nga administratat publike	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogari të tjera të administratave publike	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	1,371,248	4,308,951	-	-	-	9,245	-	3,081,523	-	8,770,966
Borxhe të përfaqësuara nga letrat me vlerë	-	-	-	-	-	9,245	-	3,081,523	-	3,090,768
Letra me vlerë të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes REPO	1,371,248	4,308,951	-	-	-	-	-	-	-	5,680,199
Të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
DETYRIME TË TJERA	-	592,494	1,178,087	-	-	-	-	-	-	1,770,581
BURIMET E PËRHERSHME	105,950	37,274	2,338	27,208	64,013	127,859	316,473	3,448,579	49,007,518	53,137,213
I-TOTALI I PASIVEVE	2,968,299	224,555,550	4,272,697	9,215,682	45,275,824	35,474,581	54,637,844	63,931,351	52,624,824	492,956,652
II- Zerat jashte bilancit	-	632,034	-	1,412,770	-	10,031	-	1,987,456	-	4,042,291
-Angazhime financiare te marra (pjesë e paperdorur e linjave te kredise)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
- fonde (valute + leke) e shitur ne afat	-	632,034	-	1,412,770	-	10,031	-	1,987,456	-	4,042,291
TOTAL (I+II)	2,968,299	225,187,584	4,272,697	10,628,452	45,275,824	35,484,612	54,637,844	65,918,807	52,624,824	496,998,944

Tabela 16: Depozita ekuivalente e kapitalit të degës së bankës së huaj

N/A

Tabela 17: Matja dhe kontrolli i kufijve të rrezikut të degës së bankës së huaj

N/A

Tabela 18: Politikat e shpërblimit

Informacion cilësor (a):

i- Komiteti i Burimeve Njerëzore të Bankës kryen funksionin e Komitetit të Shpërblimit. Anëtarët e Komitetit të Burimeve Njerëzore emërohen nga Bordi i Drejtorëve. Anëtarët kanë mandat të pacaktuar.

Përbërja e Komitetit të Burimeve Njerëzore:

- 1- Drejtori i Përgjithshëm – Kryetar i Komitetit
- 2- Drejtori i Grupit të Operacioneve dhe Bankingut Dixhital – Anëtar
- 3- Drejtori i Rrjetit të Degëve & Çështjeve Administrative – Anëtar
- 4- Drejtuesi i Departamentit të Burimeve Njerëzore – Anëtar

Njësia raportuese dhe zbatuese e Vendimeve të Komitetit të Burimeve Njerëzore është Departamenti i Burimeve Njerëzore.

ii- Politika e shpërblimit të bankës ka qëllim, të shpërblejë dhe të motivojë financiarisht punonjësit e bankës dhe duke ofruar një paketë pagesë sa më kompetitive duke inkurajuar arritjen e rezultateve sa më të larta dhe të qëndrueshme. Të lidhë objektivat personale me ato të kompanisë dhe të ulë riskun e personelit sipas parimeve të Qeverisjes së Korporatës.

Politika e shpërblimit aplikohet për të gjithë punonjësit pavarësisht linjave dhe fushave të punës.

iii- Të gjitha linjat kanë riskun e punës së tyre, i cili është në raport të drejtë me autoritetin dhe përgjegjësitë që ato mbulojnë, datë 30 Qershor 2024.

- Linja e Biznesit ka 303 punonjës
- Linja e Operacioneve ka 467 punonjës
- Linja e Auditit ka 28 punonjës
- Linja e Riskut ka 68 punonjës
- Linja e IT ka 148 punonjës
- Linja e Burimeve Njerëzore ka 9 punonjës
- Linja e Stafit Suport 17 punonjës
- Drejtuesit Ekzekutivë janë 8 punonjës.

Informacion cilesor (b):

- i- Objektivat i politikës së shpërblimit synojnë motivim financiar të punonjësve mbështetur mbi parimin e barazisë/drejtësisë të vlerësuar sipas kriterëve të merita/performancës, përgjegjësia/funksioni, eksperiencë/qendrueshmëria, nivelin profesional/edukimi, nivelin e riskut dhe konkurrenca e tregut.
- ii- Nuk ka pasur ndryshim të politikave të shpërblimeve gjatë kësaj periudhe.
- iii- Banka ka siguruar procedurat standarde dhe e politikave të shpërblimeve dhe kompensimit në teresi, të cilat bëjnë diferencimin në përpjesëtim të drejtë për linjat e punonjësve që mbartin risk me të lartë në punë me qëllim motivimin e tyre sa më të madh.

Informacion sasior (c):

- i- Banka merr në konsideratë dhe ben përpjekjet maksimale për evitimin e riskut gjatë procesit të zbatimit të masës së shpërblimit duke zbatuar rigorozisht parimet e drejtësisë/barazisë në trajtimin e punonjësve, aplikimin standard dhe të njëtrajtshëm të kriterëve të vendosura për shpërblim, informimin e barabartë të të gjithë punonjësve për politikën dhe procedurat që lidhen me shpërblimin dhe transparencën në zbatim.
- ii- Masat kryesore të përdorura nga Banka për të vlerësuar efektshmërinë e politikave të shpërblimit dhe vlerësimin e riskut janë rezultatet e detajuara të sondazheve/pyetesoreve të kryera periodikisht për të gjithë punonjësit mbi këto politika të cilat janë matës të riskut, dhe të cilat vlerësojnë riskun e brendshëm jo vetëm për shpërblimet por edhe për politikën e kompensimit financiar dhe të benefiteve në teresi.
Në lidhje me matjen e riskut të jashtëm, Banka merr pjesë në survey zyrtare vjetore, organizuar nga Shoqata e Bankave për tregun bankar në lidhje me kompensimet dhe benefitet.

Informacion sasior (d):

- i- Matës të kryesore të performancës për bankën dhe për punonjësit janë:
Treguesit financiarë, pjesa e tregut sipas produkteve dhe në teresi, performanca e punonjësit, njesive, përgjegjësia/funksioni, eksperiencë/qendrueshmëria, niveli profesional/edukimi.
- ii- Mesatarja e treguesit shpërblime vjetore/pagës baze vjetore = 12.8%.
- iii- Kontrolli i kufizues i politikës së shpërblimeve.

Informacion sasior (e):

Banka aplikon Politikën e Planit të Investimit për stafin e nivelin drejtues, e cila e parashikon investimin (ngurtesimin) 2 vjeçar të vlerësuar se bonusit të performancës për këtë segment me norme atraktive të interesit. Punonjësi përfiton principlin+interesin e investimit pas maturimit 2 vjeçar në bazë të performancës së qendrueshme dhe vazhdimin të punës në bankë.
Gjithashtu përshtatja e politikës së pagave dhe shpërblimeve në periudhë afatgjatë lidhet me kriteret e performancës së bankës, indeksin e cmimeve të konsumit dhe performancës individuale dhe konkurrenca brenda tregut bankar.

Informacion sasior (f):

Format e shperblimeve të punonjesve sipas elementeve te ndryshueshem te kriterëve janë si me poshte:

- 1- Shperblimet individuale – kriter performance e matshme ne realizimin e traqeteve per produkte dhe sherbime.
- 2- Shperblimet per njesite – kriter performance e e matshme e treguesve të njesise per produkte dhe sherbime.
- 3- Shperblimet per projekte – kriter realizimi ne kohe i projekteve dhe perfitueshmeria e tyre.
- 4- Shperblimet per Stafin Drejtues – kriter performance individuale, e njesise dhe bankes.

Informacion sasior (g):

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2024 janë zhvilluar 5 mbledhje të Komitetit të Burimeve Njerëzore. Anëtarët e Komitetit të Burimeve Njerëzore duke qenë punonjës të BKT, për pjesëmarrjen e tyre në këtë komitet nuk trajtohen me pagesë të vecantë.

Tabela 19: Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për Këshillin Drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë është bërë në “cash” dhe përfshihet tek zëri i shpenzimeve të personelit. Detajet janë si më poshtë (në mijë Lek):

	Viti i mbyllur më 30 Qershor 2024	Viti i mbyllur më 30 Qershor 2023
Këshilli Drejtues	116,564	95,516
Drejtuesit ekzekutivë	98,812	143,533
	215,376	239,049

Tabela 20: Politikat kontabël

Baza e përgatitjes

Pasqyrat e konsoliduara financiare janë të shprehura në Lek, të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt, nëse nuk është shënuar ndryshe dhe janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç se për letrat me vlerë të vendosjes, të cilat llogariten me vlerën e tregut.

Parimet kontabël të zbatuara nga Banka, janë të njëjta me ato të përdorura në përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023.

Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë kthyer me kursin e këmbimit në datën kur është kryer transaksioni. Aktivitetet dhe pasivitetet monetare, të shprehura në monedhë të huaj, të cilat kontabilizohen me koston historike në datën e transaksionit, janë këmbyer sipas kursit të këmbimit në datën e raportimit. Aktivitetet dhe pasivitetet jo monetare, të shprehura në monedhë të huaj, në vlerën e tyre historike, jepen me kursin e këmbimit në datën kur është bërë transaksioni. Diferencat që rrjedhin nga ndryshimi i kursit të këmbimit të valutave të aktiveve e pasiveve monetare janë treguar në pasqyrën e të ardhurave tek “Fitimi (humbja) nga rivlerësimi i valutave, neto”.

Kapitali i paguar është trajtuar si një zë monetar dhe është rivlerësuar në përputhje me parimin e shpjeguar më sipër. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, kapitali në monedhë të huaj duhet të paraqitet në bilancin e konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit dhe një “rezervë rivlerësimi” e krijuar në kapitalin e aksionarëve që përfaqëson diferencën në Lek ndërmjet kursit të fundit të periudhës me kursin historik që përdoret për të regjistruar kapitalin e paguar në monedhë të huaj.

Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore

Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë dhe gjendje të pakushtëzuara në bankat qendrore, subjekt i një rreziku jo domethënës ndaj ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore mbahen në pasqyrën e bilancit të konsoliduar me kosto të amortizuar.

Depozita dhe llogaritë me bankat

Depozitat dhe llogaritë me bankat përfshijnë depozita ndërbankare dhe zëra që janë në procesin e arkëtimit.

Bonot e thesarit

Bonot e thesarit janë klasifikuar në dy kategori si aktive të vendosjes ose deri në maturim dhe regjistrohen fillimisht me kosto plus interesin e përlllogaritur. Bonot e thesarit janë klasifikuar duke u bazuar në qëllimin dhe aftësinë e Bankës për t’i mbajtur deri në maturitet.

Letrat me vlerë të vendosjes

Letrat me vlerë të vendosjes janë instrumente jo-derivative të cilat janë klasifikuar si të mbajtura për shitje. Letrat me vlerë të vendosjes regjistrohen në çmimin e tregut, me interesin e përlllogaritur për kuponat për t’u paguar. Çdo skonto ose prim i paguar mbi vlerën nominale në momentin e transferimit përlllogaritet deri në datën e pagesës së principalit të letrës me vlerë. Letrat me vlerë të vendosjes, pas regjistrimit të tyre fillestar rimaten me vlerën e tregut dhe humbjet që shkaktohen nga ndryshimi i vlerës së tregut të

letrave të vendosjes përfshihen tek fitimi dhe humbja neto për periudhën përkatëse. Këto letra me vlerë konsiderohen si të vendosjes pasi Banka ka si qëllim shitjen e tyre përpara datës së maturimit.

Letrat me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimit që mbahen deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të përcaktuar, të cilat Banka ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje. Investimet që mbahen deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me interesin e përlogaritur për kuponat për t'u paguar. Çdo skonto ose prim i paguar mbi vlerën nominale në momentin e blerjes përlogaritet deri në datën e pagesës së principalit të letrës me vlerë.

Huatë dhe paradhëniet për klientët

Huatë dhe paradhëniet për klientët raportohen mbi vlerën e tyre neto me provigjionin e humbjeve specifike nga huatë. Provigjionet krijohen në zbatim të rregullores Nr. 62 të Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja” (Rregullorja rrezikut të kredisë) e miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës datë 14 shtator 2011 (ndryshuar për here të fundit me date 30 Mars 2016). Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë huatë e saj në gjashtë kategori rreziku.

“Kredi me probleme” – janë kreditë e klasifikuara në tre kategoritë e fundit të klasifikimit të kredive.

Provigjionimi i interesit për kategoritë Nenstandarde, Dyshimta dhe të Humbura është 100%
Për çdo kategori rreziku, janë zbatuar normat e mëposhtme të provigjioneve:

Lloji i huasë	Ditë vonese për overdraftet	Ditë vonese për huatë me afat	Norma e provigjionit
Standarde	0 ditë	0 ditë	1%
E pakthyer në afat	1-30 ditë	1-30 ditë	1%
Në ndjekje	31-60 ditë	31-90 ditë	5%
Nënstandarde	61-90 ditë	91-180 ditë	20%
E dyshimtë	91-180 ditë	181-365 ditë	50%
E humbur	Mbi 180 ditë	Mbi 365 ditë	100%

Huatë dhe paradhëniet për klientët raportohen mbi vlerën e tyre neto me provigjionin e humbjeve specifike nga huatë e klasifikuara si nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Provigjionet e krijuara për humbje të mundshme nga huatë e klasifikuara si standarde, të pakthyer në afat dhe në ndjekje janë regjistruar si provigjione statistikore në anën e detyrimeve të bilancit.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar.

Për llogaritjen e normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra të cilat janë një pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet rrjedhin nga shërbimet financiare që ofrohen nga Banka, si transferime fondesh, mbajtjen e llogarive, aktivitetet e huadhënies dhe të tregtimit financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv në një aktiv ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv. Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat njihen në momentin që ofrohen shërbimet e lidhura me to.

Shpenzime të tjera nga komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

Tatimi mbi fitimin

Banka përcakton shumën e tatueshme në fund të vitit në përputhje me legjislacionin Shqiptar të tatimeve. Në 30 Qershor të vitit 2024, tatimi mbi fitimin është i barabartë me 15% (2023: 15%) të fitimit të tatueshëm. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke modifikuar fitimin para tatimit për zëra të caktuar të ardhurash dhe shpenzimesh në përputhje me legjislacionin shqiptar. Fitimi përpara tatimit bazohet mbi regjistrimet financiare të mbajtura nga Banka për qëllime rregullatore në përputhje me MRF dhe mund të ndryshojë ndjeshëm nga rezultati financiar i raportuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”). Për më tepër, MRF nuk kërkon që Banka të masë dhe të regjistrojë aktivet dhe detyrimet e shtyra.

Në përcaktimin e shumës së tatimit të vitit Banka merr në konsideratë efektin e disa pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse do ketë detyrime për tatime apo interesa shtesë. Banka beson se shpenzimet e saj të përlllogaritura për detyrime tatimore janë të përshtatshme për të gjithë vitet tatimore duke e bazuar vlerësimin e saj në shumë faktorë, përfshirë dhe interpretimin e legjislacionit tatimor dhe përvojat e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë disa gjykime për ngjarje të ardhshme. Informacione të reja që mund të bëhen të ditura, mund të bëjnë që Banka të ndryshojë vlerësimin e saj për përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime do të ndikojnë shpenzimin tatimor në periudhën që bëhet përcaktimi.

Plani i pensionit

Banka ka krijuar një fond për planin e pensionit (Programi Mbështetës për Stafin – ‘SSP’) i sponsorizuar tërësisht nga punëdhënësi në vitin 2002. Shuma që do të regjistrohej tek ky fond, vendosej në fillim të vitit në masën 5% të shpenzimeve vjetore të planifikuara për pagat e personelit. Gjatë vitit, shumata e përlllogaritur regjistrohej tek pasqyra e të ardhurave dhe tek fondi në bazë mujore. Shumat që Banka i detyrohet punonjësve në bazë të planit të mësipërm do të rriten me të ardhura bruto nga interesi nga data që punonjësi largohet nga Banka deri në momentin e daljes në pension.

Shumat do t’u paguhen punonjësve vetëm kur ata arrijnë moshën e pensionit sipas ligjit shqiptar, në këste mujore të barabarta me një minimum prej 75% të pensionit të tyre shtetëror mujor derisa fondi i akumuluar për punonjësit konsumohet.

Bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues, të hyrë në fuqi më 30 Shtator 2010, Banka ka ndërprerë investimin në fondin SSP, duke e transformuar atë në Programin e Kreditimit të Qëndrueshmërisë së Stafit (‘SRCP’). Shuma e llogaritur për secilin punonjës përfitues nga SSP u ngurtësua në të njëjtën ditë. Shuma e ngurtësuar dhe interesi përkatës vjetor që do të gjenerohet nga investimi në të ardhmen në letra me vlerë



BANKA KOMBETARE TREGTARE

të klasifikuara AAA deri në daljen në pension të punonjësit, do t'i shtohet fondit të investimit nga ana e Bankës.

Aktive të qëndrueshme dhe rregullim i ambienteve me qira

Pronat dhe pajisjet janë të shprehura me kosto minus amortizimin e akumuluar, i cili është llogaritur me mënyrën lineare mbi jetën e përdorimit të vlerësuar për këto aktive.

Toka nuk amortizohet.

Amortizimi është llogaritur në përputhje me normat e mëposhtme:

Ndërtesa dhe rregullimi i ambienteve me qira	5%
Mjete transporti	20%
Pajisje dhe mobilim zyre	20%
Pajisje TI dhe elektronike	25%
Pajisje	20%

Veprimet spot të këmbimit valutor

Banka gjatë aktivitetit normal të punës kryen veprime spot të këmbimit valutor, me data shlyerje pas një ose dy ditësh pas datës së transaksionit. Këto transaksione regjistrohen tek zërat jashtë bilancit në datën e transaksionit dhe njihen në datën e shlyerjes së transaksionit.